

mbrojtjen nga diskriminimi”, subjektet kundër së cilëve drejtohet ankesa në fjalë duhet të operojnë në fushën e të mirave dhe shërbimeve⁴, ose në një ndër fushat, për të cilat parashikohet mbrojtje nga diskriminimi në këtë ligj. Në ankesën e Znj. L.R., subjektet kundër së cilëve drejtohet ankesa, janë persona fizikë, për të cilët, ankuesja ka parashtruar problematikën përkatëse, por anjëri prej tyre nuk përfshihet në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, apo në ndonjë prej fushave të tjera, të mbrojtura me dispozitat ligjore⁵.

Komisioneri gjykon se në bazë të parashikimeve në dispozitës së sipërpërmendur, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, shtetasit T. S., L.M.dhe S.SH. nuk legjitimohen si subjekte kundër së cilëve mund të paraqitet ankesë pranë Komisionerit. Për sa më sipër, në referencë të nenit 33, pika 4, gërma b), Komisioneri gjykon se kjo ankesë është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në në nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 17 dhe 44, pika 2, nenin 65, gërma b) dhe nenit 128, pika 1, të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenet 1, 4, 7, pika 1, 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a) dhe neni 33, pika 4, gërma b), të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 157, datë 03.10.2018, e Znj. L. R., për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

Shkak –“gjinia”, “identiteti gjinor”, “gjendja arsimore”, “gjendja shoqërore”, “përgjegjësia prindërore”, “gjendja civile” dhe “përkatësia në një grup të veçantë”

⁴ Referuar Kreut IV, neni 20, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

⁵ Bëhet fjalë për fushën e arsimit dhe fushën e punësimit, parashikuar nga Kreu II dhe Kreu III, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.